



SPECIFIKIMET TEKNIKE

ILLYRIAN GUARD SH.A
“Server + Storage NAS”

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Autoritet Kontraktues: Illyrian Guard Sh.A

1.2. Historiku

"Illyrian Guard" sh.a është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, datë 4 Prill 2019, si Shoqëri me kapital 100 % shtetëror, për ofrimin e shërbimeve ndaj personave fizikë e juridikë, publikë dhe privatë. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100 % të aksioneve të shoqërisë “Illyrian Guard”, sh.a., është Ministria e Brendshme. Shoqëria “Illyrian Guard”, sh.a., ofron shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit. Shoqëria “Illyrian Guard”, sh.a., ofron shërbime mbështetëse në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj, në zbatim të kompetencave që i njihen kësaj të fundit sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore. Mënyra e përlogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që u ofrohen subjekteve publike, janë përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie, për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike. "Illyrian Guard" vjen si një alternativë e re në treg, duke garantuar profesionalizëm, cilësi maksimale si dhe sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit. Përdorimi i teknologjisë së avancuar dhe infrastruktura kontribuon në ofrimin e një

shërbimi me cilësi të lartë dhe garanton konfidencialitetin e informacionit. Në fokus të Shoqërisë janë gjithashtu kërkimet teknologjike të thelluara në funksion të sigurisë fizike dhe kibernetike.

Qëllimi i Illyrian Guard SH.A është të implementojmë sistemet më të avancuara ndërkombëtare në funksion të ruajtjes dhe të krijojmë partneritet me kompanitë lider në botë.

2. QËLLIMI I PUNËS

2.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është si më poshtë:

- Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- VKM Nr.177, datë 04.04.2019 “ Për krijimin e shoqërisë “Illyrian Guard” SH.A”
- VKM Nr. 945, datë 02.11.2012 Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.

Të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale në respekt të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në veçanti të Nenit 27 “Masat e sigurisë për të dhënat personale” dhe Nenit 28 “Konfidencialiteti i të dhënave” të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe udhëzimeve dhe vendimeve të miratuara nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KËRKESAT FUNKSIONALE

1. Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë instalimin dhe konfigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme për këtë projekt.
 - Përsa i përket konfigurimeve është detyrë e operatorit ekonomik kryerja e të gjitha konfigurimeve të nevojshme përse i përket:
 - a. Instalimin dhe Konfigurimin e Servera-ve
 - b. Instalimin dhe Konfigurimin Storage
2. Garancia e ofruar për pajisjet fizike do të jetë sipas modelit të secilës pajisje, të përcaktuar më poshtë në specifikimet teknike dhe në pikën 8 .
3. Serveri do të jetë i ndarë në 2 (dy) Servera fizik për load balancing, failover dhe high availability, servera të cilët do të përdoren për monitorimin e Sistemeve të vëzhgimit me kamera të objekteve në ruajtje të Shoqërisë Illyrian Guard SH.A.

4. Storage NAS do të jetë një “Back Up” për ruajtjen e pamjeve filmike në ambientet e Illyrian Guard Sh.A të objekteve që ka në ruajtje, ku në Storage NAS do të jenë të importuara Paisjet e Vëzhgimit me IP-të përkatëse. Përmes kësaj synohet rritja e sigurisë, me qëllim shmangien e humbjes të informacionit Video të ruajtura në karta memorije të kamerave teke, si dhe sistemeve të vëzhgimit me kapacitete të ulëta (sisteme vëzhgimi me 4/8/16 kanale) të ruajtur në HDD singlë point of failure për shkak të ndodhjes të vetëm një HDD në këto sisteme vëzhgimi.
5. Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit për procedurat e sigurisë dhe mirëmbajtjes së serverit dhe Storage NAS si dhe përdorimin e tyre.
6. Operatori ekonomik merr përsipër integrimin e pajisjeve të monitorimit të sistemeve të sigurisë që AK ka në pronësi në Storage NAS që do të instalohet. Pajisjet duhet të jenë plotësisht të integrueshme me infrastrukturën aktuale të Illyrian Guard.
7. Specifikimet teknike do të jenë vetëm për pikat 1 dhe 2 në tabelen e mëposhtme.
8. Garancia e Produkteve do të jetë (3 Vite) për pikat 1, 2, 3 .

➤ **Lista e Pajisjeve dhe Materialeve**

Nr.	Përshkrimi
1.	Server
2.	Storage NAS
3.	HDD 8 TB i dedikuar për Video Surveillance
4.	Zgjatues Tastiere 15 deri 20 meter me port 3.0
5.	Zgjatues Mause 15 deri 20 meter me port 3.0
6.	Priza RACK PDU Profesionale

○ **Kërkesat dhe Funkcionet e Storage NAS**

- a) Storage NAS duhet të sigurojë regjistrimin automatik të videove (digjitale) nga kamerat apo pajisjet e vëzhgimit të vendosura në objektet e Illyrian Guard Sh.A, dhe duhet të ofrojë kapacitet të mjaftueshëm për të ruajtur videot për të paktën dhjetë ditë.
- b) Storage NAS duhet të sigurojë funksionim të vazhdueshëm dhe të montohet në raft (rack).
- c) NAS duhet të suportojë funksionalitetin e kërkimit të informacionit Video sipas kriterëve të kërkimit si: Data dhe Ora, lloji i ngjarjes.




Figura nr. 1

- d) Storage NAS duhet të suportojë funksionin e regjistrimit dhe funksionin e shikimit të informacionit Video (playback).
- e) Storage NAS duhet të ketë funksionin e regjistrimit të disa flukseve video njëkohësisht (Network Video Recorder, Digital Video Recorder) dhe të ketë funksionin e regjistrimit të një fluksi video (IP Camera).
- f) Storage NAS duhet të suportojë protokollin e komunikimit ONVIF, RTSP për të marrë fluksin e videos pavarësisht sistemit të kamerave që është implementuar. **(Figura nr. 1)**
- g) Storage NAS duhet të ofrojë funksionin e enkriptimit të HDD, për të bërë të mundur rritjen e sigurisë në rast dështimi të videos.
- h) Storage NAS duhet të ofrojë një ndërfaqe web-i, për të bërë të mundur konfigurimet e nevojshme Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit Illyrian Guard Sh.A.
- i) Storage NAS duhet të disponojë minimumi 48 slote për vendosjen e HDD-ve ku secili prej tyre duhet të suportojë HDD me kapacitet të paktën Min. 8TB.
- j) HDD që do të përdoret duhet të jetë i dizenuar për regjistrim në pajisje CCTV.
- k) HDD duhet të jenë rezistent për të regjistruar me kapacitet të plotë 24/7.
- l) Storage NAS duhet të ketë të paktën 6 ndërfaqe data rrjeti, kjo për të patur hapësirë sa më të madhe në bandwidth duke përfituar çdo frame nga secila video.
- m) Storage NAS duhet të ketë një ndërfaqe menaxhimi të pavarur nga ndërfaqet e tjera për të patur akses në çdo moment për të bërë ndryshime në pajisje, pavarësisht në rast avarie teknike rrjeti në ndërfaqet e rrjetit, porta e menaxhimit mban aksesin mbi pajisjen.


➤ **Specifikimet Teknike sipas listës së dhënë më sipër:**

1. Server

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
a) Pikët e Procesorit sipas www.cpubenchmark.net	<ul style="list-style-type: none"> • 2x procesor me Min. 25000 pikë
b) Form Factor	<ul style="list-style-type: none"> • I montueshem në rack, të ketë të përfshirë shinat dhe aksesoret e nevojshem për montim në Rack.
c) RAM	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 128 GB 4x32GB, Min.DDR4 2933 ose 3200 MHz ose më mirë e shtueshme deri në 1 TB.
d) Karta Grafike PCI (GPU)	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 24 GB e dedikuar Gen4 ose më mirë • Min. 3x Porta te cilat mund të jenë : DVI,HDMI,DP,mDP ose të tjera .
e) DVD-RW	<ul style="list-style-type: none"> • Min.1 External USB DVD-RW Optical Disk Drive .
f) Power Supply	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 2x 1600W (230V) Hot-Swap .
g) Network	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 4-port 10Gb LAN . • PCIe 10Gb 2-Port SFP + Ethernet Adapter .
h) USB	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 4x porta nga të cilat 2x të jenë porta 3.0 .
i) Security	<ul style="list-style-type: none"> • TPM 2.0 ose me mirë .
j) HDD	<ul style="list-style-type: none"> • Minimumi 4 x 1000 GB NvMe, Raid 10 .
k) Sistemi operativ:	<ul style="list-style-type: none"> • Të Suportoje: Min. Microsoft Windows Server, Linux,VMware ESX . • Windows i instaluar: Microsoft Windows Server 2022 Datacenter.
l) VGA	<ul style="list-style-type: none"> • Minimumi 1 porte VGA .
 Garancia	3 vite

2. Storage NAS

Karakteristikat	Vlerat Specifike Minimale
✓ Modaliteti i Storage NAS	<ol style="list-style-type: none"> Të mbështesë aksesimin e kamerave përmes protokolleve të paktën RTSP, ONVIF, PSIA ose të tjera . Supports mixed storage of video stream and picture Stream . Supports remote backup, local backup . Të ofrojë nivelin e mbrojtjes i cili të mbrojë të dhënat nga dështimet e njëkohshme të 2 (dy) HDD-ve ose “disqeve” ose 4 (katër) HDD-ve ose “disqeve” së ruajtjes . Të ofrojë bllokimin e videove për mbrojtjen e të dhënave .
a. Procesor	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 2x 64-bit 6-core processors .
b. Cache	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 64 GB DDR4 (e zgjerueshme deri në 256 GB) ose më mirë .
c. Performanca	<ul style="list-style-type: none"> • Rregjistrimi në video Min. (2 Mbps) 600-ch recording + playback .
d. Network	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 1x portë menaxhimi 1000Mbps Ethernet . • Data network interface Min. 6, 1000M Ethernet interface (8 × GbE or 4 × 10GbE extendable) .
e. HDD	<ul style="list-style-type: none"> • Të Suportoje Min. SSD/SAS/SATA . • Të ketë Min. 48 Slote për HDD . • Disk detection pre-alarm and repair . • Të Suportoje Hot-swapping .

f. USB Port	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 3x Porta nga të cilat Min.1 Port 3.0 .
g. Power	<ul style="list-style-type: none"> • Min. 1 + 1, \leq 1600 W .
h. Alarm Method	<ul style="list-style-type: none"> • Min. Audio, indicator .
i. Temperatura	<ul style="list-style-type: none"> • Funksionimi (Operating) : Min 5 °C deri në 40 °C . • Ruajtja (Storing) : Min -10 °C deri +60 °C .
 Garancia	✓ 3 vite